



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

|                        |                                                                                                           |
|------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Datë/Datum/Date:       | 21.07.2026                                                                                                |
| Për/Za/To:             | z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës së Junikut                                                            |
| Cc:                    | znj. Venera Çerkini - Sekretare e Përgjithshme,<br>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| Nga/Od/From:           | Komisioni Komunal për korrje - shirje 2026                                                                |
| Tema/Subjekat/Subject: | Raporti mbi fushatën e korrje - shirjeve 2026                                                             |

I/E nderuar,

Komisioni Komunal, i emëruar nga Kryetari i Komunës së Junikut, z. Ruzhdi Shehu, me Vendimin nr. 01/122, datë 30.06.2026, për monitorimin dhe realizimin e korrje - shirjeve për vitin 2026, ka këtë përbërje:

Besart Tofaj – Nënkryetar i Komunës së Junikut, kryesues i komisionit

Florentina Qestaj – Zyrtare për Bujqësi, anëtare e komisionit

Idriz Gacaferi – Inspektor i Ndërtimit, anëtar i komisionit

Komisioni Komunal, nga dita e emërimit, vazhdimisht ka qenë në terren, duke u njohur me vështirësitë dhe problemet e fermerëve dhe autokombajnerëve gjatë realizimit të procesit të korrje - shirjes, njëkohësisht duke u ofruar mbështetje profesionale për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe vështirësive të mundshme.

Në Komunën e Junikut, korrje - shirja e grurit ka filluar më datë 05.07.2026, ndërsa më datë 18.07.2026 ka përfunduar procesi i korrje - shirjeve.

Është e rëndësishme të theksohet se në këtë operativ kanë marrë pjesë tre autokombajna, ku gjendja mekanike e tyre ka qenë e mirë dhe nuk ka pasur humbje të grurit.

Operativa e korrje - shirjes, përkundër disa problemeve të vogla, është realizuar ashtu siç është hartuar dhe planifikuar nga Komisioni Komunal.

Vlen të përmendet se çmimi për korrjen e një hektari, i rekomanduar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka qenë 140 euro/ha. Ky çmim i rekomanduar është respektuar nga autokombajnerët.

Në bazë të të dhënave nga terreni, rendimenti mesatar këtë vit ka qenë 4,200 kg/ha, i cili kryesisht është dërguar në mullinjtë më të afërt në Gjakovë, Pejë dhe Rahovec. Gjithsej kanë qenë të mbjella 93.77 hektarë me grurë, sipas të dhënave të nxjerra nga 34 fermerët që kanë aplikuar për subvencione për sipërfaqet e mbjella me grurë.

Sfida kryesore që është paraqitur gjatë korrje - shirjes është:

- Parcelat me sipërfaqe të vogla dhe të shpërndara.
- Qasja e kufizuar në parcela për shkak të rrugëve sezonale dhe mospastrimit të tyre.

Për përfundimin me sukses të korrje - shirjeve, përveç kushteve të mira meteorologjike, kanë ndikuar edhe disa faktorë:

1. Prezenca e tre autokombajnave nga Komuna e Gjakovës.
2. Prezenca e Komisionit Komunal për monitorimin e korrje - shirjeve.

Komisioni vlerëson se fushata e korrje - shirjeve është zhvilluar me sukses në tërë territorin e Komunës së Junikut dhe se të gjithë bujqit që kanë pasur të mbjellë kulturën e grurit kanë arritur ta korrin atë me sukses.

Me respekt!